



Zj. Tea Blakaj Hoxha

Sekretari i Përgjithshëm i
Qëndrës së Arbitrazhit



Sektori i biznesit në Kosovë mund të ketë menduar, pse duhet të arbitrojë? Nëse më pyesni mua, neutraliteti i arbitrazhit, konfidencialiteti dhe aftësia për t'u përshtatur me nevojat e bizneseve e bëjnë arbitrazhin mjetin perfekt për të zgjidhur mosmarrëveshjet tregtare. Pavarësia dhe paanshmëria e Gjykatës së Arbitrazhit, e cila nëpërmjet profesionisteve me përvojë-arbitrave, vetëm plotësojnë përfitimet e lartpërmendura të këtij mjeti, duke nxitur të përdoren dhe përshtaten me nevojat e komunitetit të biznesit. Me këtë në mendje, kundërpyetja do ishte "pse jo"?

Arbitrazhi është krijuar si një mekanizëm i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në fushën e tregtisë. Në arenën ndërkombëtare, arbitrazhi është pranuar si një proces i bërë për t'u përshtatur me specifikat e të bërit biznes. Arbitrazhi siguron dhe garanton procedurë të shpejtë dhe efikase. Kur krahasohet me punën e gjykatave në Republikën e Kosovës, efikasiteti i procedurës i shprehur me miratimin e shpejtë të vendimit përfundimtar duhet të kishte rezultuar në interesim më të lartë të komunitetit të biznesit ndaj arbitrazhit. Ndërkohë që është ende në krye, në krahasim me departamentet e tjera të Gjykatave Themelore, Departamenti i Tregtisë i Gjykatës Themelore në Prishtinë ende përballet me shumë sfida dhe vështirësi në punën e tij, siç janë rastet e prapambetura dhe mungesa e ekspertizës për zgjidhjen e duhur të çështjeve me natyrë tregtare. Vetë gjyqtaret e këtij departamenti

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E NJË TRIBUNALI ARBITRAZHI

mbrojnë arbitrazhin, duke që në të vetëdijshtëm për aftësinë e tij për t'iu përgjigjur me saktësi nevojave të bizneseve.

Arbitrazh do të thotë ta zgjidhësh çështjen tende me ndihmën e një eksperti të pavarur dhe të paanshëm, profesionist i një fushe të caktuar, ose tre të tillë, me sigurinë që çështja do të zgjidhet me transparence dhe konfidencialitet absolut, falë masave mbrojtëse që garanton procedura e arbitrazhit.

Si të tilla, çështjet e arbitrazhit duhet të trajtohen me tej, të analizohen dhe të zgjidhen nga një gjykatë arbitrazhi. Me fjalë të tjera, çështja do të trajtohet, analizohet dhe zgjidhet nga një arbitër ose një panel arbitrash që janë zgjedhur nga palët në çështje. Por, si funksionon në të vërtetë kjo?

Procedura e arbitrazhit është filluar dhe themeluar e bazuar mbi klauzolën e arbitrazhit, rënë dakord nga të dyja palët, brenda kontratës së tyre origjinale. Në të vërtetë, kjo klauzolë e arbitrazhit përcakton Tribunalin e Arbitrazhit. Me këtë klauzolë, palët bien dakord për institucionin që duhet të arbitrojë mosmarrëveshjen e tyre. Gjithashtu, mund të bien dakord për vendin, rregullat e procedurës, përfshirë numrin e arbitrave, gjuhën e përdorur në procedurë dhe në legjislacionin në fuqi. Parë nga një këndvështrim tjetër, palët, në të vërtetë, kanë kompetencën për të krijuar të gjithë procedurën ose, me fjalë të tjera, për të

për të krijuar Tribunalin e tyre të Arbitrazhit, të përbërë nga një numër i caktuar arbitrash që do të dinë, që nga fillimi, cilat rregulla dhe cili legjislacion duhet të zbatohen, në gjuhën e procedurave. *A tingëllon mirë, apo jo?* Sidoqoftë, bizneset në Kosovë i shmangin klauzolat e arbitrazhit, edhe pse janë shumë të pakënaqur me punën e gjykatave.

Tribunali i Arbitrazhit themelohet kur arbitrat emërohen me marrëveshjen e të dyja palëve. Para themelimit dhe marrjes së rolit të një arbitri, ky i fundit është i detyruar të ofrojë një *deklarate të pavarësisë* që garanton paanshmërinë ndaj palëve dhe, gjithashtu, zbulon konfliktin e interesit të mundshëm, i cili mund, nëse pajtohet kështu nga palet, t'i shkëpusë këta arbitra nga procedurat e mëtejshme. Megjithatë, pasi bien dakord për emërimin e arbitrave, palët themelojnë *Tribunalin e Arbitrazhit*.

Pas themelimit, Tribunali merr përsipër procedurat, duke filluar nga kërkesa e paraqitur. Arbitrat, nëpërmjet kompetencave që u janë dhënë atyre nga rregullat dhe rregullorja e gjykatës, udhëheqin gjithë procesin dhe veprojnë në përputhje me rregullat e parashikuara të procedurës. Palët në çështje duhet të jenë të vetëdijshëm për faktin që mund të ketë çështje që nuk parashikohen nga Rregullat e Procedurës. Përsëri, raste të tilla u lihen palëve, që t'i zgjidhin ato reciprokisht ose të delegojnë kompetencën tek Tribunali i Arbitrazhit për të vendosur për çështje të tilla.

Një nga çështjet imediate që është zgjidhur dhe ndryshuar (kjo bazuar në praktiken brenda nivelit të arbitrazhit ndërkombëtar), ishte çështja e *konfliktit të interesit* midis një arbitri dhe një konsulenti ligjor të njëres nga

palët. Ka pasur raste kur institucionet e arbitrazhit nuk kishin parashikuar veprime në lidhje me situata të tilla dhe, për këtë arsye, ishte e vështirë të vlerësohej reagimi ndaj situatës kur konflikti i interesit nuk ishte i dukshëm *prima facie* ose vetëm pretendohet se ekzistonte nga njëra prej palëve. Duke ditur se vendimi përfundimtar në të tilla raste mund të jetë i lehtë të kundërshtohet nga pala tjetër, është e domosdoshme që një çështje e tillë të vlerësohet me kujdes nga praktikuesit e arbitrazhit. Në ditët e sotme, rregullat dhe udhëzimet e institucioneve të arbitrazhit u kushtojnë më shumë vëmendje rasteve të konfliktit të interesit duke siguruar kështu më shumë mbrojtje ndaj procesit dhe qëndrueshmërisë së vendimit të arbitrazhit.

Detyrimet e arbitrave janë të qarta kur bëhet fjale për zbulimin e konfliktit të interesit ose ndonjë informacion tjetër që mund të përbëjë kërcënim ndaj pavarësisë dhe paansësisë së tyre. Në rastet kur, bazuar në informacionin e dhënë nga një arbitër, një palë ngre dyshime për paanshmërinë e arbitrit, bazuar në arsyetim objektiv, kjo palë mund të kërkojë largimin e atij arbitri. Masa të tilla parashikohen që të garantojnë pavarësinë dhe paansësinë e një arbitri dhe të mos lënë hapësirë për diskutim të vendimit përfundimtar të arbitrazhit.

Duke ditur se nuk ka të drejtë të ankimojë vendimin përfundimtar, një palë të pakënaqur i është lënë shumë pak hapësirë për të paraqitur kërkesën për anulimin e vendimit të arbitrazhit në gjykatën kompetente. Arsyet ligjore për anulim të tillë janë ato të parashikuara në Konventën e Nju Jorkut për Njohjen dhe Ekzekutimin e Vendimeve të Arbitrazhit që janë



transpozuar si të tilla brenda legjislacionit kombëtar, siç është rasti në Republikën e Kosovës. Arsye të tilla lidhen vetëm me shkelje të mundshme të procedurës së arbitrazhit dhe, bazuar në këtë fakt, Tribunali i Arbitrazhit është i detyruar ta udhëheqë procesin e arbitrazhit në mënyrë të kujdesshme, bazuar në rregullat e shkruara dhe parimet e të drejtës, barazisë dhe efikasitetit të procedurave.

Masat mbrojtëse të vendosura në procedurat e arbitrazhit duhet të shërbejnë për ta bindur komunitetin e biznesit që arbitrazhi është mjeti më i mirë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në fushën e tregtisë. Pikëpamja ime është që bizneset duhet, të paktën, të kërkojnë më shumë informacion dhe të shprehin interes të mëtejshëm për të kuptuar procedurën, në mënyrë që prirja e ndjekur ndërkombëtarisht të pranohet nga bizneset që veprojnë në vendet e Ballkanit Perëndimor. Studiuesit dhe praktikuesit e arbitrazhit nga Ballkani Perëndimor janë përpjekur shumë për ta futur arbitrazhin në sektorin e biznesit nga dëshira për të shitur idenë e duhur, në kohën e duhur, në sektorin tregtar që bën biznes në vendet në tranzicion, që duhet, në interesin e tyre, të përshtaten me mekanizmat e përhapura dhe të miratuara ndërkombëtarisht, të tilla si arbitrazhi.

Në përbërjen e Tribunalit të Arbitrazhit, palët, lehtësisht, gjejnë pavarësi të garantuar, paanshmëri dhe garanci absolute të transparencës në proces. Me e rëndësishmja, Tribunali i Arbitrazhit ofron ekspertizë, e cila është thelbësore për zgjidhjen e çështjes dhe kënaqjen e interesit kryesor të palëve. Përtej të gjithave, Tribunali i Arbitrazhit është i detyruar të

ruajë konfidencialitetin, duke qenë kështu një mjet shtesë për të mbrojtur reputacionin e biznesit. Me gjithë këto në mendje, bizneset duhet ta provojnë dhe të zgjedhin një procedurë arbitrazhi në mënyrë që të provojnë përfitimet dhe përparësitë e tij. Në fund të ditës, pse jo?

Mohim: Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë artikull janë vetëm deklarata personale të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pozicionin e ICC Albania. Përmbajtja e artikullit është vepra origjinale e autorit. Autori merr përgjegjësinë për çdo shkelje të autorësisë. Versioni origjinal i artikullit është në gjuhën angleze

